GJAKOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica - Municipality of Gjakova
ARKIVA DALËSE
IZLAZNE ARHIVE
OUTPUT ARCHIVES
Nr.Inv/Br.Inv 01-011/01-16232
Data/Datum/Date 02.04.2026
Gjakovë - Djakovica - Gjakova

**Kuvendi i Komunës së Gjakovës**
**01 Nr. __________/2026**
**Datë:31.03.2026**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 dhe nenin 61 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL)Nr.03/2023 për Procedurat e Emërtimit të Nënkryetarëve në Komuna, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.03.2026, pas diskutimit lidhur me pikën e 6 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për emërimin e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete, e miratoi këtë:

**V E N D I M**

**1.** Kuvendi i Komunës së Gjakovës emëron z. Artan Berisha nënkryetar të Komunës për Komunitete në Komunën e Gjakovës.

**2.** Nënkryetari i Komunës për Komunitetet në Komunën e Gjakovës ushtron detyrat dhe përgjegjësit e tij në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, si dhe me aktet tjera ligjore dhe nënligjore që janë në fuqi në Republikën e Kosovës.

**3.** Nënkryetari i Komunës për Komunitetet do ti ndihmoj Kryetarit të Komunës dhe do të ofroj këshilla dhe udhëzime lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet jo shumicë në Komunën e Gjakovës.

**4**. Nënkryetari i Komunës për komunitetet emërohet me mandat të njëitë si të Kryetarit të Komunës.

**5.** Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

**6. Vendimi iu dërgohet:**
- Kryetarit të Komunë së Gjakovës z. Ardian Gjini .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Nënkryetarit të Komunës për Komentet z. Artan Berisha.
- Njësisë për menaxhimin e Burimeve Njerëzore.
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit.

**Shefqet Shehu**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA

| | |
|---|---|
| *Data/nr* | 19.03.2026 01-112/02-13626 |
| *Për:* | Shefqet Shehu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës |
| *CC:* | - Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës<br>- Arkivit |
| *Nga:* | Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës |
| *Lënda:* | Propozim vendim për emërimin e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete |

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 58 dhe 61 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen, dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2023 për Procedurën e Emërimit të Nënkryetareve në Komuna, Kryetari i Komunës së Gjakovës me datë 19.03.2026 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

## PROPOZIM VENDIM

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miratojë vendimin për emërimin e z. Artan Berisha në pozitën e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete.

2. Nënkryetari i Komunës për Komunitete në Komunë të Gjakovës, detyrat dhe përgjegjësitë e tij do ti ushtrojë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale si dhe me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Nënkryetari për komunitete do t'i ndihmojë kryetarit dhe do të ofrojë këshilla dhe udhëzime për kryetarin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin pakicë.

4. Nënkryetari për Komunitete do të emërohet për mandat të njëjtë si të kryetarit.

Me respekt